



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1131_05_14**;
- Ankesa e KEDS-it e datës 23.05.2014.

në seancën e mbajtur më datë 24 qershor 2014, nxorri këtë:

V E N D I M

- I REFUZOHE** ankesa e KEDS-it ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin I. B., me shifër të konsumatorit: DPR - 6422) nga Prishtina ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_1131_05_14 i datës 06.05.2014.

Arsyetim

Punëtoret e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori me datë 15.04.2008 kanë dal te konsumatori dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë hequr nga matja njehsorin elektrik nr. 34229900 dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 1068493, ku të njëjtin e kanë dërguar në qendrën e kalibrimit për shqyrtim dhe verifikim. Pas kësaj punëtoret e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse prapë me datë 02.05.2008 kanë bërë inspektimin e pikës matëse te konsumatori, dhe kanë konstatuar se gjatë verifikimit të faturave pa shpenzim elektrik njehsori elektrik është trefazor dy tarifor, blloibat distributive dhe shtetërore janë në rregull, gjithashtu u theksuar se numëruesi i njehsorit nuk është i njëjtë me atë të regjistruarin në CCP nr. 34229900 (në CCP), ndërsa në teren është 1068493.

Me datë 16.06.2008 punëtorët e qendrës së kalibrimit kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 34229900, dhe kanë konstatuar se njehsori elektrik blloibat shtetërore i ka të manipuluar, të hapura dhe prapë të mbyllura, nga ana e jashtme qelqi i thyer, numëruesi është i manipuluar, ka gjurmë të kthimit mbrapa të numrave në numëror.

Pas procesverbalit të qendrës së kalibrimit punëtoret e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse me datë 18.07.2008 kanë bërë inspektimin e pikës matëse te konsumatori dhe kanë konstatuar se me kërkesë të shërbimit të kalibrimit kemi marr shënimet në lidhje me furnizimin e njehsorit elektrik, me tej është theksuar se njehsori nga ana teknike është në rregull dhe ka ketë furnizim, hyrja në njehsor është me kabëll 4x4 mm², dalja nga njehsori është me kabëll 4x4 mm² deri te siguresa shkrirëse.



Me datë 19.09.2008 nga laboratorit i kalibrimit është lëshuar protokollin mbi shqyrtimin e njehsorit elektrik, ku është theksuar se njehsori nuk mund të shqyrtohet pasi që qelqi i njehsorit të thyera e pengon punën e diskut.

Departamenti i Faturimit në KEK me datë 23.10.2008 e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPR08HP06773 në vlerë financiare prej 1,772.20€. Pas kësaj fature konsumatori ka parashtruar ankesë në KEK duke kundërshtuar këtë faturë. Departamenti për konsumator në KEK pas shqyrtimit të ankesës e ka refuzuar ankesën e konsumatorit.

Konsumatori pas marrjes së përgjigjes së KEK-u ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të konsumatorit. DMK pas parashtrimit të ankesës së konsumatorit ka bërë shqyrtimin e ankesës dhe me datë 06.05.2014 ka nxjerr vendim duke e aprovuar ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEDS-i, që të shkarkojë konsumatorin nga fatura e rikthimit të humbjeve DPR08HP06773 të datës 23.10.2008 në vlerë financiare prej 1,772.20€.

Baza e kundërshtimeve të KEDS-it të theksuara në ankesë është se DMK e ZRRE-së ka bërë konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe ka bërë zbatim të gabuar të dispozitave ligjore, për faktin se sektori i kalibrimit me datë 16.06.2008 ka konstatuar se njehsori padyshim është i keqpërdorur ngase blloibat i ka të manipuluar dhe prapë të mbyllura, nga ana e jashtme qelqi është i thyer, si dhe numëruesi është i manipuluar, ka gjurmë të kthimit të numrave në numëror.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 24 qershor 2014 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEDS-it, përkatësisht bazën e kundërshtimit dhe pas vlerësimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës ka vlerësuar se argumentet e prezantuara nga ana e KEDS nuk janë bindëse për faktin se me asnjë provë nuk ka argumentuar se DMK ka bërë gabimisht vlerësimin e provave gjatë vendosjes së kësaj çështje dhe se cilën dispozitë ligjore e ka shkelur. Bordi i ZRRE-së ka konstatuar se sipas analizave të bëra shpenzimit të energjisë elektrike para dhe pas ndërrimit të njehsorit elektrik është vërejtur se nuk ka ndryshim të madh në shpenzim me njehsor të ri. Mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike me njehsorin e vjetër nga periudha 08/2002 deri 11/2006 është 830.02 kWh/muaj, ndërsa me njehsor të ri nga 05/2008 deri 12/2013 është 915.35 kWh/muaj, që krahasuar në përqindje i bie që diferenca e rritjes së shpenzimit me njehsor të ri është vetëm 10%. Nga analiza e bërë rrjedhës së shpenzimit të energjisë elektrike është vërejtur se në këtë pikë matëse konsumatori është faturuar pa shpenzim të energjisë dhe gjendja e shpenzimit figuron të jetë zero kWh, dhe atë nga periudha 12/2006 deri në periudhën kohore 04/2008 kur edhe është bërë ndërrimi i njehsorit elektrik nga punëtorët e autorizuar të KEK-ut. Nga kjo vërehet se KEK-u për 16 muaj e ka lënë konsumatorin që t'i regjistrohet zero shpenzim të energjisë elektrike dhe nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të verifikuar dhe të sanoj problemin, kur dihet se për çdo muaj pika matëse e konsumatorit lexohet nga punëtorët e autorizuar të ndërmarrjes së energjisë

Bordi i ZRRE-së gjatë shqyrtimit të ankesës ka theksuar se meqë sipas konstatimeve të bëra në procesverbalin e kalibrimit se qelqi i njehsorit elektrik është i thyer, ky dëmtim është dashur të evidentohet edhe në procesverbalin e ndërrimit të njehsorit elektrik të përpiluar nga vet KEK, ndonëse në procesverbalin e ndërrimit të njehsorit elektrik nuk është evidentuar, andaj është e paqartë se a ka qenë njehsori elektrik në gjendje e tillë edhe më herët apo jo. Duhet theksuar se njehsori elektrik ka qenë i vendosur në ndërtesë kolektive ku kanë pasur qasje në këtë pikë matëse shumë banor, dhe për këtë KEK-u ka qenë e obliguar të bëjë sigurimin e pikës matëse në mënyrë që mos të dëmtohen njehsorët elektrik.

Mbështetur në nenin 8 paragrafi 8.3 të Rregullës për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike theksohet: *“Konstatimet e parregullsisë funksionale të njehsorit elektrik siç përcaktohet në nenin 3 paragrafi i) të konstatuara në laboratorin e kalibrimit nuk mund të*



përdoren si provë e vetme meritore për ngarkimin e konsumatorit me faturën e rikthimit të energjisë së humbur”.

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se KEDS në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 24.06.2014 ka analizuar ankesën e KEDS dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK_V_1131_05_14, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmive tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar